

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit
Titulli i lëndës:	Zhvillimi i bizneseve dhe Ndermarresia ne Turizem
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. As. Dr. Leonora Rudhani
Detajet kontaktuese:	leonora.rudhani@ushaf.net
Përshkrimi i lëndës	Lënda ka për qëllim që në mënyrë konceptuale të paraqesë zhvillimin e bizneseve dhe ndermarresise, kompleksitetin e zhvillimit dhe rritjes së një biznesi, duke përfshirë edhe vlerësimin e përparësive, dobësive, shanseve dhe kërcënimeve të cilat e rrethojnë mjedisin biznesor. Lënda ofron njohuritë bazë mbi çështjet teorike dhe praktike në fushën e ndërmarrësise së turizmit, njohjen e mundësive dhe krijimin e ideve te reja, fokusimin në vlerësimin e fuqisë dhe qëndrueshmërisë financiare të ndërmarrjeve turistike, ideve, vlerësimin e mundësive, blerësit, planet biznesore, tregun, sfidat e rritjes se ndërmarrjeve turistike.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është që të përgatisë studentët me njohuri teorike dhe praktike se si të drejtojnë një biznes. Lënda është e dizajnuar që studentët të jenë të aftë të zhvillojnë dhe avancojnë biznesin dhe ndërmarrësinë në fushën e turizmit. Studentët do të zhvillojnë shkathtësitë e nevojshme për një ndërmarrës të suksesshëm. Ata do të analizojnë aspekte specifike me të cilat do të ballafaqohen gjatë zhvillimit të ndërmarrësisë dhe do të fitojnë shkathtësi të nevojshme në menaxhimin e resurseve në mënyrë eficiente.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studenti duhet të jetë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> • vlerësojë rolin e ndërmarrësisë, duke përfshirë ndërmarrësinë korporatave në zhvillimin e turizmit rajonal / lokal.

	<ul style="list-style-type: none"> • analizojnë procesin e sipërmarrjes dhe vlerësojnë ndikimin e mjedisit të jashtëm në aktivitetet sipërmarrëse në turizëm. • diskutojnë karakteristikat e organizatave sipërmarrëse dhe bizneset e vogla dhe të mesme familjare dhe të shpjegojnë mënyrat e menaxhimit dhe organizimit të tyre. • zbatojnë parimet themelore të ndërmarrësisë në menaxhimin e ndërmarrjeve turistike 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	5	10
Ushtrime në teren (vizitë studimore)			
Kollokfiime, seminare			
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	6	3	18
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
Projektet, prezentimet ,etj	3	1	3
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata interaktive me studentë lidhur me temat e ligjërara, orientimi në shtjellimin e materialit duke marrë raste studimi të cilat do të diskutohen në grup, mësimi duke u bazuar në një problem të paraqitur, prezantimi i studenteve për Raste studimi, Punime seminarik-shkencore, Ese apo Hulumtim.		
Metodat e vlerësimit:	60 pikë – nga provimi final i cili do të jetë i organizuar me minimum 5 pyetje me shkrim/goje, 40 pikë – Punimi i studentit dhe diskutimi interaktiv për: Rast studimi, Punimi seminarik-shkencor, Ese apo Projekt hulumtues.		
Literatura			
Literatura bazë:	<i>1. Morrison, A., Rimmington, M. and Williams, C (2011) Entrepreneurship in the Hospitality, Tourism and Leisure</i>		

	<i>Industries, Abingdon, Routledge.</i>
Literatura shtesë:	<p>2. <i>Barringer, BR & Ireland, RD (2011), Entrepreneurship: Successfully Launching New Ventures (4th ed.), London: Prentice Hall (or latest edition).</i></p> <p>3. <i>Green, JV (2013) The Opportunity Analysis Canvas, Venture Artisans Press.</i></p>
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	<p>Hyrje në ndërmarrësinë e turizmit</p> <p>Njohja me konceptet, terminologjinë dhe përkufizimet që mbështesin studimin e turizmit, kuptimin e problemeve që lidhen me studimin akademik dhe praktik të turizmit</p>
Java e dytë:	<p>Ndermarresia</p> <p>Veçoritë e Ndërmarrësit, Ideja e Ndërmarrësit, Atributet individuale të ndërmarrësit, procesi i ndërmarrësisë, përcaktimi dhe realizimi i strategjisë</p>
Java e tretë:	<p>Njohja e mundësive dhe krijimi i ideve</p> <p>Kuptimi i ideseve të ndërmarrësit, burimet e ideseve të ndërmarrësit, Metodatat e gjenerimit të ideve të reja: Fokus grupet, Shkrimi i trurit, Inventarizimi i problemave dhe analiza, Brainstorming, SWOT Analiza</p>
Java e katërt:	<p>Analiza e Fizibilitetit</p> <p>Kuptimi i analizës së fizibilitetit, procesi i fizibilitetit, forma e analizës së fizibilitetit, Pese forcat e Porterit, Analiza e fizibilitetit të produktit ose shërbimit</p>
Java e pestë:	<p>Hartimi i një Biznes plani i një ndërmarrjeje turistike</p> <p>Pergatitjet e planit të biznesit, Permbajtja e Biznes planit, Angazhimi i punës kreative, Pjesët e përbashkëta të Biznes Planit</p>
Java e gjashtë:	<p>Analiza e Industrisë dhe Konkurrencës</p> <p>Analiza e industrisë, Barrierat për të hyrë në treg, Fuqia e blerëse e konsumatorëve, Fuqia e furnitorëve, Produktet zëvendësuese, Rivaliteti konkurrues, Analiza e konkurrentit, Avantazhi konkurrues</p>
Java e shtatë:	<p>Zhvillimi i një modeli efikas të biznesit</p> <p>Zhvillimi i një Modeli Efektiv të Biznesit, Strategjia kryesore, Burimet strategjike, Rrjeti i partneritetit, Sfidat e zbatimit të strategjisë së biznesit dhe modelit të biznesit</p>

Java e tetë:	Efikasiteti i Biznesit Efikasiteti i Biznesit, Marrja e rrezikut, pershtatshmeria dhe fleksibiliteti, Faktoret e suksesit te nje biznesi, <u>Njohja e tregut</u> , <u>Niveli i zhvillimit të industrisë</u> , <u>Menaxhim i aftë</u> , <u>Kontrolli financiar</u> , <u>Paraprirja e ndryshimeve</u>
Java e nëntë:	Përgatitja e fondacionit të duhur etik dhe ligjor Çështjet etike dhe ligjore fillestare që has një firmë e re, paraqitja e nje kulture te forte etike, elementet kryesore te etikes, kodi etik dhe mardheniet ne biznes, shmangia e mosmarrëveshjeve ligjore
Java e dhjetë:	Vlerësimi i fuqisë dhe qëndrueshmërisë financiare të ndërmarrjes së re turistike Sfidat e sektorit te turizmit, strategjite e turizmit, faktoret e suksesit, integrimi i politikave, Instrumentet financiare, bashkepunimi ne praktikë, angazhimet e perbashketa, Partneritetet Publike Private
Java e njëmbëdhjetë:	Ndërtimi i një ekipi të ri të ndërmarrjes turistike Ndërtimi i ekipit, rëndësia e ekipit, përfitimet e punës në ekip, rëndësia e bashkëpunimit në ekip, avantazhet, Menaxhimi i kohës / detyrës brenda ekipeve
Java e dymbëdhjetë:	Burimet e financimit të ndërmarrjeve turistike Financimi i ndërmarrjes, kapitali i pronarit, fitimet e mbajtura, financimi nga burimet e huaja (eksterne)
Java e trembëdhjetë:	Çështjet unike të marketingut Fazat e procesit te segmentimit te tregut, Stategjite kryesore te marketingut, Variablat per segmentimin e tregut, Perzgjedhja e tregut te synuar, Krijimi i një pozicioni unik në treg
Java e katërbëdhjetë:	Përgatitja dhe vlerësimi i sfidave të rritjes së ndërmarrjeve turistike Turizmi- Sfidat e rritjes, Ndikimi i Koronavirusit në Turizmin Global, Kostoja e pushimeve dhe inflacionit, Rreziku & Siguria e Turistëve, Çështjet Rregullatore dhe Kufitare
Java e pesëmbëdhjetë:	1. Prezantim i punimeve

Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.